



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:2462/24, Datë 03.12.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së tretë të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 26.11.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës për korrigjimin e vendimit të KShC-së Ref.:1222/24 i datës 05.08.2024.
- II. Korrigjohet vendimi i KShC-së Ref.:1222/24 i datës 05.08.2024, ku paragrafit I të dispozitivit i shtohen dy specializimet:
Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik, me 2 specializime:
 1. *Termoenergjetika dhe Termoteknika dhe*
 2. *Sistemet e Energjisë së Ripërtëritshme.*
- III. Pjesa tjetër e vendimit Ref.:1222/24 i datës 05.08.2024 mbetet në fuqi dhe e pa ndryshuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM


Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për korrigjimin në aspektin përmbajtjesor të vendimit **Ref.:1222/24** i datës **05.08.2024** me të cilin Riakreditohet programi i studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme MSc 120 ECTS, me 2 specializime;</i> <i>1. Termoenergjetika dhe Termoteknika dhe</i> <i>2. Sistemet e Energjisë së Ripërtëritshme),</i>	Naser Sahiti Drilon Meha Bukurije Hoxha

Me qëllim të eliminimit të gabimeve, pas shqyrtimit të kërkesës KShC vendosi që të bëhet korrigjimi i vendimit duke bazuar në nenin 50 (1) të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative [Korrigjimi i gabimeve të dukshme në një akt administrativ]: “Organi publik, në çdo kohë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, mund të korrigjojë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme, të dukshme, në një akt administrativ.” (...).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 26.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në kërkesën, dispozitat ligjore të lartës cekura dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në UP;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,